

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – SHERBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **Objekti i procedurës:** “Trajnim i stafit për Flight Procedure Design Office”.
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (cpv):** 79998000-6 – Shërbime trajnimi; 80510000-2 – Shërbime të trajnimit të specializuara.
- **Vlera e fondit limit:** 7,500,000 (shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor ALBCONTROL SHA ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: *kriteret e mesipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: i ndryshuar citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Çertifikatë ose Licensë që vërteton njohjen si ofrues i shërbimit të trajnimit të procedurave të fluturimit me instrumente nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë ose të vendit përkatës për dhënien e këtij trajnimi, konformë specifikimeve teknike të DST.

Argumentimi: *Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për*

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të provojnë përshtatshmërinë dhe të jenë të licensuar për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale objekt kontrate, për realizimin me sukses të kontratës.

2.1.2 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin e kontratës, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë CV- të dhe Kontratat e Punës së trajnuesve, ku numri minimal i trajnuesve është 2, të cilët do të perfshihen në trajnimin e procedurave të fluturimit me instrumente, duke iu referuar rregullave të publikuara në ICAO Doc 8168 - OPS/611 (PANS-OPS) Vol. II (i aplikueshëm për procedurat konvencionale për avionët me krahë të fiksuar).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të provojnë përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale objekt kontrate.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja mesatare vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati

i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Për Autoritetin Kontraktor ALBCONTROL sh.a, plotësimi i këtij kriteri është i rëndësishëm pasi shërbimet e mëparshme të ngjashme të realizuara në sektorin publik apo sektorin privat janë kushte të nevojshme që garantojnë se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të mëparshme të ngjashme vërtetojnë se zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses këtë procedure prokurimi. Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- **ISO 9001: 2015** “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”

Argumentimi:

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve. Certifikata duhet të jenë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Sqarojmë se Albcontrol sha, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane 1035/2011 dhe të audituar nga ana e Agjensisë Europiane të Sigurisë së aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë komptibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtarë të Aviacionit Civil sipas Rregullores së Komisionit European EC 552/2004 si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative.

Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit dhe në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve.

2.3.3. Në rast se Operatori Ekonomik është përfaqësues i autorizuar i ofruesit të shërbimeve përkatëse, (Akademisë ose autoriteti i licensuar për këtë shërbim), kjo vertetohet me dokumentacionin përkatës të përfaqësimit e leshuar nga ofruesi i shërbimeve.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Ofruesi i shërbimeve duhet të provojë se organizata e cila do të kryejë trajnimin disponon certifikatë ose licensë që vërteton njohjen si ofrues i shërbimit të trajnimit të procedurave të fluturimit me instrumente duke iu referuar rregullave të publikuara në ICAO Doc 8168 - OPS/611 (PANS-OPS) Vol. II (i aplikueshëm për procedurat konvencionale për avionët me krahë të fiksuar), nga institucionet përkatëse shtetërore të Republikës së Shqipërisë ose të vendit përkatës për dhënien e këtij trajnimi konform kërkesave të Shtojcës Nr. 5. (specifikimet teknike).

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të shërbimit që kërkohet të blihet e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termat e Referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimin objekt procedure prokurimi, natyrën dhe afatin kohor për realizimin e këtij shërbimi si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 41/1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Shënim: *Përcaktimi i specifikimeve teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

SPECIFIKIME TEKNIKE

Trajnimi i hartuesve të procedurave të fluturimit

1 TË PËRGJITHSHME

1.1 Qëllimi

1.1.1 ALBCONTROL, Ofruesi i Shërbimeve të Llundrimit Ajror në Shqipëri, është përgjegjës për hartimin, validimin dhe mirëmbajtjen e procedurave të fluturimit me instrumente për aeroportet publike në Shqipëri.

1.1.2 ALBCONTROL do të sigurojë që hartuesit e ardhshëm të procedurave të fluturimit të kenë përfunduar me sukses një kurs trajnimi që u siguron atyre kompetencën përkatëse në hartimin e procedurave instrumentale të fluturimit.

1.1.3 Një Ofrues Trajnimi për Hartuesit e Procedurave të Fluturimit, i njohur dhe i miratuar nga Shteti përkatës, do të kontraktohet nga ALBCONTROL për të ofruar trajnimin fillestar për hartuesit e rinj të këtyre procedurave.

1.1.4 Trajnimi duhet të sigurojë:

- a) njohuri të rregullave teknike për hartimin dhe krijimin e procedurave të fluturimit me instrumente;
- b) njohuri të kriterëve të hartimit të procedurave;
- c) njohuri të katalogut të të dhënave, duke përfshirë DQR-të e aplikueshme; dhe
- d) kompetencë në hartimin e procedurave të fluturimit me mjete të zgjedhura në përputhje me kriteret e hartimit të këtyre të fundit;

1.1.5 Dokumenti ICAO 9906, Volumi 2 - Trajnimi i Hartuesve të Procedurave të Fluturimit -ofron udhëzime për organizimin dhe përmbajtjen e mundshme të trajnimit të hartuesve të procedurave të fluturimit;

1.1.6 Ofruesi i Trajnimit të Hartuesve të Procedurave të Fluturimit duhet gjithashtu të përmbushë kërkesat e parashtruara në Aneksin 11 të Rregullores (BE) Nr. 2017/373.

1.2 Dokumentet e referencës

1.2.1 Këto specifikime teknike për trajnimin e hartuesve të procedurave të fluturimit i referohen edicionit më të fundit të dokumenteve të mëposhtme:

- ICAO Annex 4 - Aeronautical Charts;
- ICAO Annex 15 - Aeronautical Information Services;
- ICAO Doc 9906 Volume 2 - Flight Procedure Designer Training;
- ICAO Doc 8168 Volume II – Construction of Visual and Instrument Flight Procedures;
- ICAO Doc 9613 - Performance-based Navigation (PBN) Manual;
- Easy Access Rules for Air Traffic Management/Air Navigation Services (Regulation (EU) No 2017/373);
- Easy Access Rules for Aerodromes (Regulation (EU) No 139/2014);

- Commission Implementing Regulation (EU) No 923/2012 – SERA.

2 KURSI I TRAJNIMIT

2.1 Të Përgjithshme

2.1.1 Sipas ICAO Doc 9906 Vol. 2, trajnimi fillestar i Hartuesve të procedurave të fluturimit përbëhet nga dy module kryesore.

2.1.2 Baza e këtij trajnimi duhet të përfshijë dhe një procedurë të publikuar fluturimi.

2.2 Kursi i Hartimit të Procedurave të Fluturimit – Moduli 1

ICAO Doc. 8168 PANS OPS Vol. II Course – Conventional Criteria

2.2.1 Përshkrimi

Ky kurs trajnimi bazohet mbi kompetencë dhe përfshin të gjitha procedurat konvencionale të fluturimit me instrumente në përputhje me kriteret e PANS-OPS.

2.2.2 Orientimi dhe Metoda e Mësimdhënies

Teoria përmes mësimëve në klasë, demonstrimeve dhe ushtrimeve e vështirëson përcaktimin e një listë e plotë ushtrimesh për shkak të nevojave të ndryshme të studentëve. Përzgjedhja optimale e ushtrimeve duhet të bazohet në zbatimin praktik të temave siç janë përcaktuar në programin e trajnimit.

2.2.3 Objektivat

Qëllimi i këtij kursi është të japë njohuri të procedurave të fluturimit me instrumente duke iu referuar rregullave të publikuara në ICAO Doc 8168 - OPS/611 (PANS-OPS) Vol. II (i aplikueshëm për procedurat konvencionale për avionët me krahë të fiksuar).

2.2.4 Parakushtet

Aftësitë themelore që kërkohen nga pjesëmarrësit janë:

- Njohuri bazike aeronautike;
- Njohuri bazike gjeodezike;
- Kompetencë matematikore ekuivalente me standardin e "shkollës së mesme";
- Anglishte e rrjedhshme.

2.2.5 Kohëzgjatja

3 javë (15 ditë, rreth 90 orë)

2.2.6 Materialet dhe mjedisi i trajnimit

Të gjithë pjesëmarrësit do të jenë të pajisur me materiale trajnimi si:

- Programi i kursit;
- “Slajde” në PowerPoint;
- Ushtrime/Teste dhe Fletore.

Duke qenë një kurs i bazuar tek mësimdhënia në klasë (me instruktor), programi kërkon një sallë trajnimi të dedikuar ose një ambient të ngjashëm, të pajisur me të paktën:

- Një stacion kompjuteri për secilin pjesëmarrës (karrige dhe tavolinë);
- Projektor;
- Tabelë dhe markera;
- Printer standard.

Gjithashtu nevojiten këto mjete shtesë:

- Stilolaps, laps, gomë;
- Letër grafike (milimetra) A3;
- Mjete ndihmëse vizatimi (vizore, raportor, etj.);
- Kompas për vizatim;
- Këndmatës;
- Materiale zyre;
- Skaner (A3/A4).

2.2.7 Certifikata

Me përmbylljen e programit të trajnimit, studentët do të pajisen me një certifikatë që dëshmon përfundimin me sukses të këtij kursi.

2.2.8 Menaxhimi i Cilësisë

ICAO Doc. 8168 PANS OPS Vol. II

Kriteret për Procedurat konvencionale¹

Tematikat	Moduli	Përshkrim
PANS-OPS Hyrje & Parimet e Përgjithshme	1	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Prezantimi i kursit ▪ Përmbledhje e dokumenteve dhe udhëzimeve të ICAO ▪ Përmbledhje e zhvillimit të DOC 8168 ▪ Përshkrimi i strukturës së DOC 8168 ▪ Seksionet kryesore të publikimeve ▪ Llojet e procedurave instrumentale të fluturimit ▪ Përlllogaritjet trigonometrike ▪ Siguria e cilësisë ▪ Përkufizime dhe akronime ▪ Njësitë e matjes ▪ Drejtimi magnetik, trajektoret dhe radialët ▪ Saktësia e sistemit navigacional ▪ Konceptet e IAS dhe TAS ▪ Zonat e mbrojtura nga pengesat

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Klasifikimi i pengesave ▪ Konceptet e MOC ▪ Siguria e cilësisë - Koncepte të përgjithshme
Pikat fikse të Zonës Terminale	1	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimi i pikave fikse dhe i zonave të tolerancës ▪ Konceptet e kthesave në pikat fikse ▪ Aplikimi operacional i pikave fikse dhe i zonave të mbrojtura nga pengesat ▪ Përdorimi i pikave fikse për zbritje dhe i zonave të mbrojtura nga pengesat të lidhura me këto pika ▪ Krijimi i zonave të mbrojtura nga pengesat - Parimet dhe aplikimet ▪ Krijimi i zonave të mbrojtura nga pengesat për menaxhimin e kthesave
Procedurat e Nisjes	1	<p>Vetëm për avionë²:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Parimet e hartimit të procedurave dhe fusha e veprimit; ▪ Pikat e nisjes, rrugët dhe krijimi i zonës së mbrojtur nga pengesat; ▪ Konceptet e MOC, identifikimi i sipërfaqeve të pengesave dhe përlllogaritja e gradientit të procedurës; ▪ Llojet e rrugëve të nisjes: <ul style="list-style-type: none"> i. Drejtëz dhe me kthesë; ii. Nisje 360 gradë (omnidireksionale).
Segmentet Konvencionale të Ardhjes	1	<p>Vetëm për avionë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Parimet e hartimit të procedurave dhe fusha e veprimit; ▪ Pikat e ardhjes, rrugët dhe krijimi i zonës së mbrojtur nga pengesat; ▪ Konceptet e MOC, identifikimi i sipërfaqeve të pengesave dhe përlllogaritja e gradientit të procedurës; ▪ Përlllogaritja e minimumeve dhe optimizimi i procedurave të hartuara; ▪ Krijimi i segmenteve STAR: Drejtëz dhe hark i bazuar mbi DME; ▪ MSA dhe TAA.
Segmentet Fillestare/Të Ndërmjetme të Procedurave Konvencionale	1	<p>Segmenti Fillestar i Ardhjes, përveç vektorizimit me radar (Vetëm për Avionë):</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Parimet e hartimit të procedurave dhe Fusha e

		<p>Veprimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Pika fikse fillestare, rrugët dhe zonat e mbrojtura nga pengesat; ▪ MOC, përlllogaritja e zonave të mbrojtura nga pengesat dhe e gradientit të procedurës; ▪ Përlllogaritja e minimeve dhe optimizimi i procedurave; ▪ Krijimi i Segmenteve Fillestare: <ul style="list-style-type: none"> o Radialet; o Harqet e bazuara mbi DME; o Racetrack; o Kthesat proceduriale; o Përlllogaritja e “Dead Reckoning”; ▪ Krijimi i Zonës së Qëndrimit (Holding): <ul style="list-style-type: none"> o Procedurat e Hyrjes; o MOC dhe Zvogëlimi i Zonës së Mbrojtur. <p>Segmenti i Ndërmjetëm i Ardhjes (Vetëm për Avionë):</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Parimet e hartimit të procedurave dhe Fusha e Veprimit; ▪ Pika fikse e Ndërmjetme, rrugët dhe zonat e mbrojtura nga pengesat; ▪ MOC, përlllogaritja e zonave të mbrojtura nga pengesat dhe e gradientit të procedurës; ▪ Përlllogaritja e minimeve dhe optimizimi i procedurave; ▪ Krijimi i Segmenteve të Ndërmjetme: <ul style="list-style-type: none"> o Drejtëz dhe me kthesë; o Segmenti i Ndërmjetëm si pjesë e procedurës “Racetrack”.
<p>Segmenti final dhe Segmenti i Papërfunduar (Missed Approach Segment) i Procedurave Konvencionale pa Precizion (NPA)</p>	<p>1</p>	<p>NPA – Segmenti Final i Afrimit (Vetëm për avionë)³:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Parimet e hartimit të procedurave dhe Fusha e Veprimit; ▪ Pika fikse Finale, rrugët dhe zonat e mbrojtura nga pengesat; ▪ MOC, përlllogaritja e zonave të mbrojtura nga pengesat dhe e gradientit të procedurës;

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përlllogaritja e minimeve dhe optimizimi i procedurave; ▪ Krijimi i Segmentit Final: <ul style="list-style-type: none"> o Drejtëz, i Zhvendosur dhe me VOR ose NDB, Me FAF \ Pa FAF; ▪ Afrim me rrotullim \ Manovrim vizual \ Manovrim vizual duke përdorur trajektore të paracaktuar (prescribed track); ▪ VSS <p>NPA – Segmenti i Papërfunduar (Vetëm për avionë):</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Parimet e hartimit të procedurave dhe Fusha e Veprimit; ▪ Pika fikse Finale, rrugët dhe zonat e mbrojtura nga pengesat; ▪ MOC, përlllogaritja e zonave të mbrojtura nga pengesat dhe e gradientit të procedurës; ▪ Përlllogaritja e minimeve dhe optimizimi i procedurave; ▪ Krijimi i Segmentit të Papërfunduar: <ul style="list-style-type: none"> o Drejtëz dhe me kthesë; o Segment i Papërfunduar me kthesë nga pikë fikse (MAPt).
Afrim Konvencional me Precizion	1	<p>Segmenti i Afrimit me Precizion ILS (Cat I)⁴:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Parimet e hartimit të procedurave dhe Fusha e Veprimit; ▪ Pika fikse Finale, rrugët dhe sipërfaqet e mbrojtura nga pengesat (Basic ILS, Annex 14); ▪ MOC, përlllogaritja e zonave të mbrojtura nga pengesat dhe e gradientit të procedurës; ▪ Përlllogaritja e minimeve dhe e shmangjes së pengesave, si dhe optimizimi i procedurave: <ul style="list-style-type: none"> o Sipërfaqet kryesore të ILS; o CRM o OAS ▪ Lidhja me segmentet Pa Precizion ▪ Krijimi i Segmenteve të ILS:

	<ul style="list-style-type: none"> o Drejtëz; o I zhvendosur; o Segmenti i Papërfunduar; o Vetëm me Udhëzim Horizontal (LOC Only – Pa Udhëzim Vertikal).
<p>Kriteret e Hapësirës së Sipërme (En-Route)</p>	<p>Kriteret e Hapësirës së Sipërme (Vetëm për avionë)⁵:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Parimet e hartimit të procedurave dhe Fusha e Veprimit; ▪ Pika fikse, rrugët dhe zonat e mbrojtura nga pengesat; ▪ MOC, MOCA, MEA, Përlllogaritja e zonave të mbrojtura nga pengesat dhe e gradientit të procedurës; ▪ Krijimi i Segmentit En-route: <ul style="list-style-type: none"> o Rrugët e bazuara mbi VOR dhe NDB; o Kombinimi i kriterëve të VOR dhe NDB; o Krijimi i Zonës së Kthesës; <p>Përmbyllja e Kursit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përmbledhja përfundimtare; ▪ Seancat e Përforcimit të dijeve; ▪ Testi final.

Shënime:

¹ Vetëm për avionë me krahë të fiksuar;

² Me përjashtim të udhëzimeve për çështje mjedisore dhe të koncepteve të operimit të njëkohshëm me pista paralele ose gati-paralele;

³ Me përjashtim të koncepteve DF;

⁴ Me përjashtim të koncepteve të mëposhtme:

- Afrime me ILS ose MLS me gradientë të lartë;
- Përcaktimi i gradientit të zbritjes me ILS / Përcaktimi i lartësive dhe i distancave të MLS;
- Afrime paralele të pavarura drejt pistave paralele në distancë të afërt;
- MLS, MLS e zhvendosur dhe azimuthi i MLS vetëm;

⁵ Me përjashtim të koncepteve të mëposhtme:

- Rrugët VOR dhe NDB - metoda e përmirësuar për krijimin e zonave të mbrojtura nga pengesat;
- Përlllogaritjet statistikore për zonat parësore dhe dytësore dhe këndi i shpërndarjes.

2.3 Kursi i Hartimit të Procedurave të Fluturimit – Moduli 2

ICAO Doc. 8168 PANS OPS Vol. II Course – PBN (RNAV/RNP) për avionë me krahë të fiksuar

2.3.1 Përshkrimi

Ky kurs trajnimi bazohet mbi kompetencë dhe përfshin të gjitha procedurat PBN (RNAV/RNP) të fluturimit me instrumente në përputhje me kriteret e PANS-OPS.

2.3.2 Orientimi dhe Metoda e Mësimdhënies

Teoria përmes mësimëve në klasë, demonstrimeve dhe ushtrimeve e vështirëson përcaktimin e një listë e plotë ushtrimesh për shkak të nevojave të ndryshme të studentëve. Përzgjedhja optimale e ushtrimeve duhet të bazohet në zbatimin praktik të temave siç janë përcaktuar në programin e trajnimit.

2.3.3 Objektivat

Qëllimi i këtij kursi është të japë njohuri të procedurave të fluturimit me instrumente duke iu referuar rregullave të publikuara në ICAO DOC 8168 - OPS/611 (PANS-OPS) Vol. II (i aplikueshëm për procedurat PBN për avionët me krahë të fiksuar).

2.2.4 Parakushtet

Aftësitë themelore që kërkohen nga pjesëmarrësit janë:

- Njohuri bazike aeronautike;
- Njohuri bazike gjeodezike;
- Kompetencë matematikore ekuivalente me standardin e "shkollës së mesme";
- Anglishte e rrjedhshme.

2.2.5 Kohëzgjatja

3 javë (15 ditë, rreth 90 orë)

2.2.6 Materialet dhe mjedisi i trajnimit

Të gjithë pjesëmarrësit do të jenë të pajisur me materiale trajnimi si:

- Programi i kursit;
- “Slajde” në PowerPoint;
- Ushtrime/Teste dhe Fletore.

Duke qenë një kurs i bazuar tek mësimdhënia në klasë (me instruktor), programi kërkon një sallë trajnimi të dedikuar ose një ambient të ngjashëm, të pajisur me të paktën:

- Një stacion kompjuteri për secilin pjesëmarrës (karrige dhe tavolinë);
- Projektor;
- Tabelë dhe markera;
- Printer standard.

Gjithashtu nevojiten këto mjete shtesë:

- Stilolaps, laps, gomë;
- Letër grafike (milimetra) A3;

- Mjete ndihmëse vizatimi (vizore, raportor, etj.);
- Kompas për vizatim;
- Këndmatës;
- Materiale zyre;
- Skaner (A3/A4).

2.2.7 Certifikata

Me përmbylljen e programit të trajnimit, studentët do të pajisen me një certifikatë që dëshmon përfundimin me sukses të këtij kursi.

2.3.8 Administrimi i Cilësisë

Me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së kurseve të ofruara, studentëve pjesëmarrës do tu kërkohet të plotësojnë një Pyetësor pas përmbylljes së trajnimit.

2.3.9 Tematikat e Kursit

Pjesëmarrësit do të përfshihen në ushtrime të krijimit të IP dhe në hartimin praktik të procedurave, gjithashtu do të angazhohen në diskutime lidhur me zbatueshmërinë e kritereve në situata normale.

ICAO PANS OPS DOC 8168 Vol. II (PBN-RNAV/RNP për avionët me krahë të fiksuar)

Tematikat	Moduli	Përshkrim
Kocepti i PBN	2	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Parimet e Hartimit të Procedurave; ▪ PBN: Specifikimet RNAV dhe RNP; ▪ Gabimi teknik në fluturim dhe tolerance e lejuar; ▪ Krijimi i zonave të mbrojtura nga pengesat dhe pikat fikse; ▪ GNSS RNAV; ▪ DME/DME RNAV; ▪ Gjatësia maksimale e segmentit që lidh dy pika fikse.
Vlerësimi i Pengesave për mbrojtjen e zonës së kthesës	2	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hyrje
RNAV T- ose Y-BAR Hartimi i Procedurës	2	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Parime të Përgjithshme
TAA	2	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hyrje
Kodifikimi i bazës së të dhënave navigacionale (Trajektorja & fund-segmentet)	2	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Parime të Përgjithshme

<p>Procedurat RNAV\RNP të Nisjes</p>		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Parimet e Hartimit të Procedurave; ▪ Pikat fikse të Nisjes, Specifikimet Navigacionale, Rrugët dhe Krijimi i zonave të mbrojtura nga pengesat; ▪ MOC, identifikimi i zonave të mbrojtura nga pengesat dhe përlllogaritja e gradientit të procedurës; ▪ Llojet e Rrugëve të Nisjes: <ul style="list-style-type: none"> o Drejtëz dhe me kthesë;
<p>Segmentet Fillestare dhe të Ardhjes RNAV\RNP En-Route</p>		<p>Pajisjet GNSS dhe DME/DME (Vetëm për avionë):</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Parimet e hartimit të procedurave dhe fusha e veprimit; ▪ Pikat fikse të Ardhjes, Specifikimet Navigacionale, Rrugët dhe Krijimi i zonave të mbrojtura nga pengesat; ▪ MOC, identifikimi i zonave të mbrojtura nga pengesat dhe përlllogaritja e gradientit të procedurës; ▪ Përlllogaritja e minimeve dhe optimizimi i procedurave; ▪ Krijimi i segmenteve të STAR: Drejtëz dhe hark i bazuar mbi DME; ▪ MSA and TAA. ▪ Krijimi i Zonës së Qëndrimit: <ul style="list-style-type: none"> o Procedurat e Hyrjes; o Krijimi i Zonës së Qëndrimit (RNP); o Shpallja.
<p>Afrimi RNP</p>	<p>2</p>	<p>Segmenti Final i Afrimit RNP Pa-Precizion bazuar në GNSS (Vetëm për avionë):</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Parimet e hartimit të procedurave dhe fusha e veprimit; ▪ Pikat fikse në Finale, Specifikimet Navigacionale, Rrugët dhe Krijimi i zonave të mbrojtura nga pengesat; ▪ MOC, identifikimi i zonave të mbrojtura nga pengesat dhe përlllogaritja e gradientit të procedurës; ▪ Përlllogaritja e minimeve dhe optimizimi i procedurave; ▪ Krijimi i segmentit final: <ul style="list-style-type: none"> o Drejtëz; o I zhvendosur; o Pikë fikse për zbritje.

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimi i Zonës së Qëndrimit <ul style="list-style-type: none"> o Procedurat e Hyrjes; o Krijimi i Zonës së Qëndrimit (RNP); o Shpallja. ▪ VSS <p>Segmenti i Papërfunduar i Afrimit RNP Pa-Precizion bazuar në GNSS (Vetëm për avionë):</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Parimet e hartimit të procedurave dhe fusha e veprimit; ▪ Pikat fikse në Finale, Specifikimet Navigacionale, Rrugët dhe Krijimi i zonave të mbrojtura nga pengesat; ▪ MOC, identifikimi i zonave të mbrojtura nga pengesat dhe përlllogaritja e gradientit të procedurës; ▪ Përlllogaritja e minimumeve, zonës së mbrojtur dhe optimizimi i procedurave; ▪ Krijimi i Segmentit të Papërfunduar: <ul style="list-style-type: none"> o Drejtëz dhe me kthesë o Me kthesë nga pika fikse e segmentit të papërfunduar;
<p>APV Baro-VNAV, SBAS dhe Afrimi me GLS</p>	<p>2</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Udhëzimi Vertikal i Navigimit me Barometër (BARO-VNAV): <ul style="list-style-type: none"> o Krijimi i sipërfaqeve të mbrojtura nga pengesat bazuar mbi segmentet Pa-Precizion; o MOC, identifikimi i zonave të mbrojtura nga pengesat dhe përlllogaritja e gradientit të procedurës; o Përlllogaritja e minimumeve dhe optimizimi i procedurave; o Korrektimi i Temperaturës – Koncepte të Përgjithshme. ▪ NPA, APV dhe CAT I — SBAS³ <ul style="list-style-type: none"> o Krijimi i sipërfaqeve të mbrojtura nga pengesat, Lidhja me segmentet Pa-Precizion, Segmenti i papërfunduar i Afrimit; o HL, Krijimi i zonave të mbrojtura nga pengesat dhe përlllogaritja e gradientit të procedurës; o Përlllogaritja e minimumeve dhe optimizimi i procedurave; o Kodifikimi i të dhënave për Segmentin Final të Afrimit (FAS Data Block);

		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Procedurat GBAS të Afrimit Me-Precizion⁴: <ul style="list-style-type: none"> o Krijimi i sipërfaqeve të mbrojtura nga pengesat, Lidhja me segmentet Pa-Precizion, Segmenti i papërfunduar i Afrimit; o HL, Krijimi i zonave të mbrojtura nga pengesat dhe përlllogaritja e gradientit të procedurës; o Përlllogaritja e minimumeve dhe optimizimi i procedurave; o Baza e të dhënave për Segmentin Final të Afrimit.
<p>Shënime:</p> <p>¹ Vetëm për avionë me krahë të fiksuar.</p> <p>² Me përjashtim të udhëzimeve për çështje mjedisore dhe të koncepteve të operimit të njëkohshëm me pista paralele ose gati-paralele..</p> <p>³ Me përjashtim të koncepteve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Afrime të njëkohshme instrumentale me ILS/MLS/GBAS/APV SBAS drejt pistave paralele ose gati-paralele; • Afrime me gradientë të lartë deri në 6.3 gradë ose 11%; <p>⁴ Me përjashtim të koncepteve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Afrime të njëkohshme instrumentale Me-Precizion (ILS dhe/ose MLS) drejt pistave paralele ose gati-paralele; 		
Përmbyllja e Kursit	2	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përmbledhja përfundimtare; ▪ Seancat e Përforcimit të dijeve; ▪ Testi final.

2.4 Lëvrimi i Trajnimit

2.4.1 Trajnimi teorik duhet të kryhet në mjediset e Ofruesit të Trajnimit dhe ofrimi i këtij trajnimi duhet të mbështetet me mjete dhe pajisje të përshtatshme për mbulimin e të gjitha temave të trajnimit.

2.4.2 Ofruesi i trajnimit duhet të emërojë instruktorë dhe vlerësuesë për mbarëvajtjen e trajnimit.

2.4.3 Mësimdhënia teorike duhet të zhvillohet nga instruktorë të kualifikuar. Ata duhet të kenë:

- 1) nivelin dhe thellësinë e duhur të njohurive në fushën ku do të jepet mësimi;
- 2) aftësi të dokumentuara për të përdorur teknika të përshtatshme mësimore; dhe
- 3) përvojë të përshtatshme në lidhje me lëndën për të cilën do të jepet mësimi.

2.4.4 Mësimdhënia mbi aftësitë praktike duhet të zhvillohet nga instruktorë të kualifikuar, të cilët duhet të:

- 1) plotësojnë kërkesat mbi njohuritë teorike dhe përvojës së punës në përputhje me mësimdhënien që ofrojnë;
- 2) kenë dëshmuar aftësi për mësimdhënie dhe për të përdorur teknika të përshtatshme mësimore;
- 3) jenë të aftë në teknikat mësimore në fushat në të cilat synojnë të japin mësim; dhe
- 4) marrin trajnime përkatëse, në përputhje me programin e trajnimit, për të siguruar ruajtjen e kompetencës së mësimdhënies.

2.4.5 Personat që janë përgjegjës për vlerësimin e kompetencës dhe aftësive të personelit duhet të:

- 1) kenë demonstruar aftësinë për të vlerësuar performancën dhe për të kryer teste dhe kontrole në fushat e mbuluara nga trajnimi;
- 2) pajisen me trajnime përkatëse, në përputhje me programin e trajnimit, për të siguruar që standardet e vlerësimit të mbahen të përditësuara; dhe
- 3) të plotësojnë kërkesat përkatëse mbi njohuritë teorike për mësimdhënien dhe të kenë përvojë të përshtatshme pune në fushën konkrete të mësimdhënies.

2.4.6 Ofruesi i Trajnimit duhet të sigurojë akomodimin e stafit për kohëzgjatjen e kursit të trajnimit.

SASIA E MALLRAVE/SHËRBIMEVE DHE AFATET E LËVRIMIT

1. Sasia e Mallrave/Shërbimeve të kërkuara

Artikulli Nr.	Përshkrimi i Mallrave/Shërbimeve	Sasia
1. Trajnimi i 3 (tre) Hartuesve të rinj të Procedurave të Fluturimit		
1.1	Certifikatat e Trajnimit për secilin modul	1 kopje origjinale dhe elektronike në format PDF për secilin pjesëmarrës
1.2	Raporti Individual i Vlerësimit	1 kopje origjinale dhe elektronike në format PDF për secilin pjesëmarrës
1.3	Progress and final tests	Kopje elektronike në format PDF për secilin pjesëmarrës

2. Afatet e Lëvrimit

2.1 Lëvrimi i mallrave/shërbimeve tek Pala Kontraktuese do të kryhet brenda 6 (muajsh) nënshkrimi i kontratës.

